

VENDIM
Nr. 620, datë 29.10.2025

PËR KALIMIN NË PRONËSI TË SHETIT DHE NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË FINANCIVE TË DY OBJEKTEVE
PUBLIKE PËR PËRDORIM NGA DREJTORIA E PËRGJITHSHME E TATIMEVE
DHE DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 9, të nenit 19, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi të shtetit dhe në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Financave për përdorim nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të 2 (dy) objekteve publike, sipas listës së inventarit, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Lista e të dhënave për Godinën 41A (Seksioni 1) dhe Godinën 41A (Seksioni 2) në zonën e re zhvillimore "5 Maji"

Nr.	Emërtimi i Kontratës	Vlera e Objektit sipas Kontratës (Ndërtim+Montim+Projektim)	Vlera e Situacionit Përfundimtar (Ndërtim+Montim)	Vlera e Studim Projektimit	Vlera e Mbikqyrjes së Punimeve	Vlera e Kolaudimit të Punimeve	Vlera Totale	Sipërfaqe Total Ndërtimi (m2)	Sipërfaqe mbi tokë (m2)	Sipërfaqja e Katit (-1) (m2)
1	Godina 41A (Seksioni 1) në zonën zhvillimore "5 Maji".	292,261,647.12	287,846,618.92	4,140,491.36	2,607,236	75,000	294,669,346	7,152.98	6,131.55	1,021.43
2	Godina 41A (Seksioni 2) në zonën zhvillimore "5 Maji".	311,285,678.35	306,877,427.51	4,408,250.84	2,646,871	77,000.00	314,009,549	7,483.17	6,268.44	1,214.73